European Training Foundation

The Vienna Institute for International Economic Studies

AXHENDA

EMRI I AKTIVITETIT	**Si ndërveprojnë Migrimi, Kapitali Njerëzor dhe Tregu i Punës në Shqipëri**
NAME	
VENDI	**Uebinar në Zoom**
DATA	**30 qershor 2021, ora 10:00 – 12:30**
REGJISTRIMI	**link Zoom**

KONCEPTIMI

Vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga tkurrja e popullsisë për shkak të lindshmërisë së ulët dhe emigrimit të vazhdueshëm. Emigrimi nga ky rajon ka qenë konstant në vitet ’90 dhe ka evoluar nga migrimi i parregullt i punës me aftësi të ulëta deri të mesme fillimisht, deri te bashkimi i rregullt familjar, studentët ndërkombëtarë dhe së fundmi migrimi i punës me atësi të larta.

Në vitin 2020, Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF) bashkë me Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw) shpalli një studim rajonal me titull "Dinamikat e migrimit nga perspektiva e kapitalit njerëzor në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi ishte që të hidhte dritë mbi marrëdhënien trepalëshe mes formimit të kapitalit njerëzor, tregjeve të punës dhe migrimit, si edhe të konstatonte se si funksionimi aktual i sistemit arsimor dhe tregut të punës ndikon te migrimi në secilin vend.

Rezultati i studimit ishte një raport kombëtar "Si Ndërveprojnë Migrimi, Kapitali Njerëzor dhe Tregu i Punës në Shqipëri", bazuar në një kuadër të përbashkët analitik hartuar nga ETF dhe wiiw.

Objektivi i uebinarit është prezantimi dhe diskutimi i gjetjeve kryesore të këtij studimi kombëtar me një grup të vogël pjesëmarrësish nga institucionet publike përkatëse, hulumtuesit, shoqëria civile dhe donatorët në Shqipëri. Temat e diskutimit përfshijnë formimin arsimor/aftësitë e emigrantëve që largohen nga Shqipëria, arsyet dhe llojet e flukseve migratore të fundit, ndikimi i tregut të punës dhe strukturave arsimore te migrimi si dhe politikat kyçe që mund të përmirësojnë marrëdhënien trepalëshe mes migrimit, arsimit dhe tregut të punës.

Rezultati i uebinarit është verifikimi dhe vlerësimi i gjetjeve kryesore të studimit për Shqipërisë. Përshtypjet që do të japin pjesëmarrësit do të pasqyrohen në versionin final të raportit i cili do të shpërndahet gjerësisht.

Hollësi organizative: Ky diskutim *online* do të mbahet në anglisht, me interpretim simultan në shqip. Pjesëmarrësit e regjistruar do të marrin në email *linkun Zoom për të hyrë në uebinar.* Jeni të lutur të hyni që në ora 9:45 për të testuar teknikalitetet dhe opsionet e zërit dhe figurës.

Uebinar: Si ndërveprojnë Migrimi, Kapitali Njerëzor dhe Tregu i Punës në Shqipëri

30 qershor 2021 (E mërkurë), ora 10:00 – 12:30

DRAFT AXHENDA

Kryesues: Romain Boitard, European Training Foundation (ETF)

09:45 – 10:00	Pranimi i pjesëmarrësve dhe testimi i teknikaliteteve (p.sh. zëri, figura)
10:00 – 10:15	Mirëseardhja dhe prezantimi • **Znj. Manuela Prina,** ETF, Përgjegjëse e Njësisë për Identifikimin dhe Zhvillimin e Aftësive • **Znj. Bora Muzaqi,** Zv.Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë • **Z. Andrea Marco Vera,** Përgjegjës i Sektorit për Zhvillimin e Qëndrueshëm Ekonomik dhe Social, Delegacioni i BE-së në Shqipëri
10:15 – 10:25 10:25 – 11:15	• **Prezantimi i kuadrit analitik për analizimin e migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregjeve të punës,** Michael Landesmann, wiiw, Koordinator Projekti • **Prezantimi i gjetjeve kryesore të studimit kombëtar për migrimin, kapitalin njerëzor dhe tregun e punës në Shqipëri,** Profesor Ilir Gedeshi, Drejtor i Qendrës së Studimeve Ekonomike dhe Sociale (QSES), Universiteti i Tiranës Pyetje dhe diskutime
11:15 – 11:25	Pushim për kafe
11:25 – 12:25	**Moderator: Ummuhan Bardak,** ETF, Specialist për Tregun e Punës dhe Migrimin Diskutim paneli për gjetjet kryesore dhe rezultatet e politikave (10 minuta komente nga palët e interesuara kryesore) ▪ **Znj. Dajna Sorensen**, Zv.Ministre e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional ▪ **Profesor Kosta Barjaba,** Shef Kabineti i Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Universiteti Evropian i Tiranës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ▪ **Znj. Luljeta Minxhozi**, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë Pyetje dhe diskutime
12:25 – 12:30	Përfundimet dhe hapat e radhës, Ummuhan Bardak, ETF